

## Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "TRESS" SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregatre" dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, une ortaku dhe z. Rossano Papini me nr. karte identiteti CA34632DF, lindur dhe banues ne Itali,krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "**TRESS**" SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me date 21/02/2022, formohet shoqeria tregtare private e quajtur "**TRESS**" SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqerise.

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Kavaje, Kavaje, magazine prane Ish- Konservave, Zone Kadatrale, Nr Pasurie 18/225, Volumi 11, Faqe 112.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objektivi i Veprimtarise

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Prodhimin e konfeksioneve tekstile cantave te ndryshme etj qe kane lidhje me rrobaqepesine.. Ajo mund te ushtroje çdo aktivitet industrial tjeter te dobishem te favorizimit dhe sigurimit te nje mbarevajtje te rregullt te prodhimit dhe mund te kryeje ne pergjithesi te gjitha veprimet industriale,tregtare,financiare,transferimin e pasurive te paluajtshme te lidhura me aktivitetin e shoqerise. Import eksport, te materialeve dhe mallrave te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise apo edhe industrial dhe ushqimore.Ditributor shpernaders i materialeve dhe mallrave qe do te perpunohen apo tregetohen neper subjektet e tjera dhe nga subjektet e tjera.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqindëmijë) Lekë.

1. Ortaku themelues z.Rossano Papini: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njeqind mije) leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

 8

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Z. Rossano Papini, i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "**TRESS**" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkrhet rregullisht nga ortakët.

Ortaku themelues:

Rossano Papini

